



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 19, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3724 Prot., datë 30.06.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor me anë të vendimeve nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19 dhe 20, datë 18.01.2023 ka vendosur hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në fushën e të drejtës civile.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit rezulton se z. {...}, gjyqtar i Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} ka paraqitur kandidatura për 3 pozicione, konkretisht për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr. 13 dhe nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e sipërcituara.

Në vijim, mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “*përvojës profesionale minimale*”, të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe të “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë.

Nisur nga kjo, Këshilli me anë të vendimit nr. 201, datë 26.04.2023 ka vendosur kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr. 13 dhe nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, ju informojmë se referuar vendimit të KLGJ-së nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

- a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit;
- b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;
- c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Për sa më sipër, Këshilli po vijon me fazën pasardhëse dhe si rrjedhojë koha e nevojshme për realizimin e gjithë këtij procesi nuk mund të përcaktohet pasi është e ndërlikur, kur është rasti, edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!